

UNIVERSITETI LUARASI
BORDI I ADMINISTRIMITNr. 110/6 Prot.Tiranë, më 15/07/2024

VENDIM

NR. 05/4. DATË 15.07.2024

I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Në Tiranë, sot më datë 15,07, 2024, në adresën: Rruga e Elbasanit nr. 59, H. 1, u mbledh Bordi i Administrimit të Universitetit "Luarasi" me pjesëmarrjen e anëtarëve të bordit.

Bordi, pasi mori në shqyrtim rendin e ditës, bazuar në nenin 49, të Ligjit nr. 80, datë 22/07/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 35, të Statutit të Universitetit "Luarasi", të miratuar me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 502, datë 08.09.2023, "Për miratimin e Statutit të Universitetit "Luarasi", të nenit 31, të Rregullores së brendshme të Universitetit "Luarasi", të miratuar me vendim të Senatit Akademik nr. 17, datë 13.11.2023, "Për miratimin e Rregullores së brendshme të Universitetit "Luarasi",

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren mbi përjashtimin/reduktimin e pagesës së tarifës së shkollimit të Universitetit "Luarasi, sipas dokumentit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, si dhe të mbikëqyrë zbatimin e saj.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

DASHNOR DERVISHI





RREGULLORE
MBI
PËRJASHTIMIN/REDUKTIMIN E
PAGESËS SË TARIFËS SË
SHKOLLIMIT
2024 - 2025

Tiranë më 15.07.2024

Hyrje

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të sigurojë një përqasje dhe procedurë të besueshme, të unifikuar, të konsoliduar e të standardizuar për përfitimin e reduktimit të pagesave të tarifës së shkollimit nga studentët e Universitetit "Luarasi", duke synuar promovimin e diversitetit përmes mbështetjes financiare së studentëve me merita të spikatura apo nga familje e komunitete të pafavorizuara që përballen me sfida financiare. Standartizimi i procesit të përkrahjes ekonomike për studentët e Universitetit "Luarasi", siguron barazi në trajtim për të gjithë aplikantët dhe një përgjigje të shpejtë, pa i lënë vend preferencave personale.

Duke patur si prioritet favorizimin e studentëve me rezultate të larta dhe nga background të ndryshëm social-ekonomik, Universiteti "Luarasi" vlerëson kushtet dhe meritat e secilit prej kandidatëve përmes programit të përjashtimit të plotë ose të pjesshëm nga pagesa e tarifës së shkollimit.

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i përmbajtjes së programit për përjashtimin e plotë ose të pjesshëm nga pagesa e tarifës së shkollimit të ofruar nga Universiteti "Luarasi", grupi i synuar (përfutuesit), kohëzgjatjen e vlefshmërisë së tyre, sasia e përfitimit, i kriterëve e kushteve për përfitimin e tyre, si dhe procedura për aplikimin, miratimin dhe përfitimin e tyre.

Neni 2

Tipologjia

1. Tipologjia e përkrahjeve ekonomike konsiston në mbështetje financiare të studentëve:
 - a) nga familjet në nevojë, të quajtur "bursë sociale";
 - b) me talent të spikatur, të quajtur "bursë ekselence";
 - c) në kuadër të përkrahjes financiare të ofruar nga pronësia e Universitetit, të quajtur "bursë mbështetëse".
2. Në përputhje me momentin e pagesës së tarifës së shkollimit për regjistrim në programin e shkollimit të ciklit të parë apo të programeve të studimit të ciklit të dytë të integruar, kandidatët përfitojnë në varësi nga koha e pagesës në kuadrin e uljeve promocionale. Përfutues janë dhe ata që transferojnë studimet nga universitetet e tjera partnere apo vijnë studimet e ciklit të dytë, pasi kanë përfunduar studimet e ciklit të parë në Universitetin "Luarasi".
3. Studentët nga e njëjta familje, me lidhje familjare si: motër – vëlla; motër – motër; vëlla – vëlla; prind – fëmijë, të cilët janë në të njëjtën certifikatë familjare; dhe burrë – grua do të përfitojnë zbritje të pagesës së tarifës së shkollimit.

Neni 3

Masa e reduktimit të përfituar

Në vlera monetare, përjashtimi i plotë ose i pjesshëm nga pagesa e tarifës së shkollimit arrijnë masën: 50% për studentët nga familjet në nevojë (bursë sociale), 50% për studentët në kuadër të përkrahjes financiare të ofruar nga pronësia e universitetit (bursë mbështetëse), si dhe në masën nga 50% deri në 100% për studentët e talentuar (bursë ekselence), të tarifave individuale të miratuara për çdo vit akademik.

Neni 4

Strukturat përgjegjëse

1. **Administratorët e njësive kryesore (fakulteteve)** kanë për detyrë si vijon:

Kërkesat e studentëve të paraqitura në formularin sipas shtojcës nr.1 bashkëlidhur dhe pjesë

përbërëse e kësaj rregulloreje u dorëzohen administratorëve të njësishë kryesore përkatëse, të cilët përgatisin një dosje të veçantë dhe brenda datës së caktuar e dorëzojnë tek koordinatori i bursave i caktuar nga Administratori i Universitetit

2. Koordinator i bursave ka për detyrë si vijon:

Koordinatori i bursave organizon kërkesat dhe përgatit një relacion të detajuar mbi përmbajtjen e kërkesave të çdo fakulteti dhe harton një përmbledhje të gjithë kërkesave, të renditura sipas veçorive të secilit person.

3. Administratori i Universitetit ka për detyrë si vijon:

Dosjen e përgatitur nga koordinatori përcillet tek Administratori i Universitetit i cili nga ana e tij menaxhon procesin për ta paraqitur në Bordin e Administrimit për marrjen e vendimeve përkatëse lidhur me përzgjedhjen e përfituesve.

4. Bordi i Administrimit merr vendimin përfundimtar mbi përfituesit.

Neni 5

Sasia e bursave për çdo njësi kryesore për Vit Akademik.

1. Sasia e bursave për çdo njësi kryesore do të jetë sa më poshtë:

- a) për studentët nga familjet në nevojë, dy për çdo fakultet, me reduktim 50%;
- b) për studentët përfitues nga bursat mbështetëse, një për çdo fakultet, me reduktim 50%;
- c) për studentët për talent të spikatur (mesatare 10.0), dy për çdo fakultet, me reduktim 50% - 100%.
- d) Në rastin kur një fakultet nuk ka studente që plotësojnë kriteret e parashikuara në lidhje me sasine dhe kategorine e bursave, atëherë vendet e lira i kalojnë fakulteteve të tjera që përmbushin kriteret në fjalë.

Neni 6

Fondet në dispozicion

Fondi në dispozicion për përkrahjen financiare për studentët për çdo vit akademik, ndahet në mënyrë të barabartë për çdo njësi kryesore, në rastin kur ka studente që plotësojnë kriteret e parashikuara. Në rast të kundërt ato shpërndahen në fakultetet e tjera sipas rastit.

Neni 7

Humbja e të drejtës së përfitimit

1. Studentët humbasin të drejtën e përfitimit të përkrahjes financiare në rast se:

- a) janë ndarë nga trangu familjar;
- b) familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private me të ardhura të konsiderueshme;
- c) vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi;
- ç) shpallen ngelës dhe humbasin vitin akademik për arsye të rezultateve jokalue;
- d) nuk kanë përfunduar programin e shkollimit brenda kohëzgjatjes normale të tij, të përcaktuar në aktin e hapjes së programit përkatës të studimit;
- dh) mbartin provime në vitet pasardhëse ose përsërisin provimin për përmirësim të notës.
- e) Kapërcejnë sezonin e provimit dhe japin provimet në sezonin pasardhës.
- ë) Studentët që kanë përfituar nga reduktimi i pagesës së parakohshme të tarifës vjetore (Early Birds).

Neni 8

Kriteret e aplikimit dhe dokumentacioni i kërkuar

1. Bursë ekselence.

- Bursë ekselence 1-vjeçare për maturantët me notën mesatare 10.00 (mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë 10.00), si dhe fituesit e vendit të parë të olimpiadave rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare në matematikë, fizikë, ekonomi, etj, ku studenti duhet të paraqesë listën e notave të noterizuar.
- Bursë ekselence për ruajtjen e mesatares 1-vjeçare për studentët që vazhdojnë studimet në Universitetin “Luarasi” dhe kanë mbaruar vitin akademik pararendës me notën mesatare 10.0 Kjo provuar nga lista e notave që studentët do të marrin në përfundim të vitit akademik, ku studenti duhet të paraqesë vërtetim nga sekretaria mësimore.

2. Bursa sociale. Anëtarë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike nga njësia e vetëqeverisjes vendore të vërtetuar me dokumentacionin përkatës dhe që kanë mestaren 8.5.

B.1 Bursa sociale për studentët: *(shuma e bursës vjetore mbi tarifën e studimit 50%)*

Për aplikantët që vërtetojnë se i përkasin shtresave vulnerabël të shoqërisë:

- për fëmijët e policit ose ushtarakut të rënë në detyrë;
- jetimët deri në moshën 25 vjeç
- ata që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë
- se është person me aftësi të kufizuara;
- që vetë deklarojnë/vërtetojnë se janë romë apo ballkano-egjiptian.

B.2 Bursa sociale për studentët që vërtetojnë si më poshtë: *(shuma e bursës vjetore mbi tarifën e studimit deri në 50%)*

Anëtarë të familjeve në nevojë ekonomike:

Rregullore e Bursave Studentore

- Bursë 50% - 144.000 lekë të ardhura në vit;
- Bursë 40% - 244.000 lekë të ardhura në vit
- Bursë 30% - 480.000 lekë të ardhura në vit
- Bursë 20% - 528.000 lekë të ardhura në vit
- Bursë 10% - 600.000 lekë të ardhura në vit

3. Bursat nga pronësia e Universitetit. Konsiderohen të tilla bursat e dhëna nga titullarët e pronësisë së Universitetit “Luarasi”.

Neni 9

Procedura

- Procedura për fitimin e kërkesave për përkrahje financiare (bursë) në përgjithësi ndjek këto hapa:
 - Publikimi i Njoftimit: universiteti publikon një njoftim që përfshin kriteret e pranimit të kërkesave, vendimet e Bordit të Administrimit mbi kriteret e përfitimit të përjashtimit të plotë ose të pjesshëm nga pagesa e tarifës së shkollimit, afatin, dokumentacionin e kërkuar dhe mënyrat e paraqitjes së kërkesave si dhe miratimit të tyre bëhen publike, nëpërmjet publikimit në faqet web të Universitetit “Luarasi”, si dhe në ambientet e institucioneve përkatëse.
 - Plotësimi i formularit: Studentët e interesuar duhet të plotësojnë një formular aplikimi, i cili mund të jetë online, i cili mund të shkarkohet direkt nga www.luarasi-univ.edu.al ose i printuar, pranë administratorit të njësisë kryesore. Formulari përfshin të dhëna personale, informacion arsimor dhe ndonjëherë mund të shoqërohet me ndonjë deklaratë arsyesh (letër motivimi) ose dokumentesh zyrtare.
 - Dorëzimi i Dokumentacionit: Studentët duhet të dorëzojnë kërkesën pranë administratorit të Fakultetit përkatës, të shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm, si p.sh:
 - dokumentet shkollorë (certifikata, listë notash, etj),

- dokumentet financiare (për të ardhurat familjare, ndihmat nga pushteti vendor),
 - letra rekomandimi,
 - Curriculum Vitae (nëse kërkohet),
 - dokumente të tjera të veçanta në varësi të llojit të përkrahjes.
- d) Verifikimi dhe Vlerësimi: Koordinator i bursave verifikon vlefshmërinë e dokumenteve dhe vlerëson e rendit kërkesat në bazë të kriterëve të përcaktuara (merita, nevoja ekonomike, formimi, etj.). Administratori analizon dhe plotëson listën e aplikantëve që plotësojnë kriteret dhe e dërgon për shqyrtim e miratim në Bordin e Administrimit.
- e) Përzgjedhja e kandidatëve: Bordi i Admisnimit shqyrton të gjitha kërkesat dhe përzgjedh kandidatët më të përshtatshëm. Në disa raste, kandidatët mund të ftohen në intervistë.
- f) Kandidatët e pazgjedhur mund të marrin një njoftim refuzimi ose një listë pritjeje, në varësi të procedurës.
- g) Njoftimi: Për njoftimin e studentëve përfitues, çdo vit administratorët e fakulteteve hartojnë listën e studentëve që kanë fituar dhe ia komunikojnë zyrtarisht përfituesve me detajet e bursës së dhënë. Në të njëjtën kohë lista i dërgohet Zyrës së Financës, Sekretarisë Mësimore dhe Zyrës së Studentit.
- h) Pranimi i Bursës dhe lidhja e kontratës sipas Shtojcës nr.2 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj kontrate: Studentët përfitues duhet të pranojnë zyrtarisht ofertën brenda një afati të caktuar, duke nënshkruar dokumentet e pranimit ose duke nënshkruar një kontratë.

Neni 10

Afati për Aplikim

Afati për aplikim, për cdo vite akademik, është prej 1 nentorit deri më 30 nentor. Në rastin kur dy kandidatë rezultojnë të barabartë në klasifikim, fiton të drejtën e bursimit ai që ka aplikuar i pari në kohë.

Neni 11

Ndryshimi i kësaj rregulloreje

1. Kjo rregullore mund të ndryshohet duke iu nënshtruar përmirësimit të vazhdueshëm, sipas propozimeve të paraqitura.
2. Çdo kërkesë e paraqitur për ndryshimin e rregullores, i kalon për vendimmarrje Bordit të Administrimit.

Neni 12

Interpretimi i rregullores

1. Të drejtën për interpretimin e kësaj rregulloreje e ka Bordi i Administrimit.
2. Për të gjithë situatat të cilat nuk rregullohen në rregulloren e mësipërme gjejnë zbatim dispozitat e përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Luarasi".

Neni 13

Miratimi dhe ndryshimi i Rregullores

Kjo rregullore miratohet dhe përditësohet me ndryshimet ligjore që mund të ndodhin, nga Bordi i Administrimit dhe zbatohet nga e gjithë struktura e sipërcituar.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj nga Bordi i Administrimit.

Miratur me Vendim të Bordi i Administrimit, nr. 05/1, datë 15.07 . 2024.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

DASHNOR DERVISHI

